- Rreziku i zhvillimit të dështimit të zembrës dhe kancerit do të ulet ndjeshëm.

### ISH-DUHANPIRËSIT NDIHMOJNË DUHANPIRËSIT

Ish-duhanpirësit mbrojnë shëndetin e familjes, miqve dhe kolegëve të tyre. Dëshira e ish-duhanpirësve për të ndihmuar duhanpirësit është e dobishme dhe e mirëpritur. Duhanpirës, pranoi ndihmën nga ish-duhanpirësit, sepse ata e dinë më së miri se çfarë do të thotë të pish duhan dhe çfarë do të thotë të jetosh pa thithur tym dhe nikotinë. Ja përse ish-duhanpirësit kanë të drejtë!

### ISH-DUHANPIRËSIT KANË VETËBESIM MË TË MADH

Lënia e duhanit është një sukses i madh, por nuk është as e thjeshtë dhe as e lehtë. Ish-duhanpirësit janë shumë krenarë për suksesin e tyre. Miqtë dhe familja juaj gjithashtu do të jenë krenarë për ju kur të lini duhanin. Vetëdija për forcën e vullnetit tuaj pasi do t'ia dilni të mposhtni një nga varësitë më të forta, ndjenja e kënaqësisë për pamjen tuaj dhe gjendjen fizike, era më e këndshme e trupit të cilën do ta vënë re edhe të tjerët, janë vetëm disa nga gjërat që do të kontribuojnë në rritjen e vetëbesimit tuaj.

### ISH-DUHANPIRËSIT KANË LIRI MË TË MADHE DHE NDJEHEN MË MIRË

Askush nuk po ju detyron të hiqni dorë nga pirja e duhanit. A ndiheni keq sepse familja dhe miqtë tuaj ju fajësojnë për pirjen e duhanit? A ju paralajmëron punëdhënësi juaj se do t'ju heqë nga puna për shkak të duhanit? A ju ka ndodhur ndonjëherë të kërkonti pa sukses një çakmak apo një fije shkrepe nga njerëz të tjerë, të dilni nga restorant midis dy shërbimeve, të humbni momentet më të mira të festave, të nervozoheni gjatë fluturimeve të gjata në aeroplan, e tërë kjo për shkak të pirjes së duhanit? Duke pasur parasysh këto dhe situata të ngjashme, pse të mos bëni përpjekje dhe të hiqni dorë nga pirja e duhanit me qëllim që të ndjeheni më mirë?

ISH-DUHANPIRËSIT KANË TË DREJTË!

### ISH-DUHANPIRËSIT DUKEN MË MIRË

Lëkura e fytyrës së ish-duhanpirësve nuk është përhirtë dhe ata nuk kanë njolla të verdha në gishta, por kanë dhëmbë të bardhë dhe flokë të ndritshëm! Lënia e duhanit është trajtimi më efektiv i bukurisë.

### ISH-DUHANPIRËSIT FLENË MË MIRË

Në moshën e rinisë mbase pirja e duhanit nuk ju sjell probleme me gjumin, por gjendja ndryshon me kalimin e viteve. Gulçimi juaj ju bën të

zgjoheni të lodhur në mëngjes, kurse pirja e duhanit gjatë natës shkakton sekretim të shtuar të adrenalinit, që çon në pagjumësi dhe e bën më të vështirë që t'ju zërë gjumi.

### ISH-DUHANPIRËSIT JANË MË PAK NERVOZË

Duhanpirësit shpesh ndezin cigare kur janë nervozë. Pas ndezjes së cigares, niveli i nikotinës në gjak rritet dhe duhanpirësit ndjehen më të qetë, por vetëm për një kohë të shkurtër. Nikotina vepron si stimulues, duke ndihmuar në çlirim të adrenalinit, i cili krijon një ndjenjë ankthi dhe nervozizmi. Për më tepër, një jetë me varësi vështirë se mund t'ju lejojë ndonjëherë të relaksoheni. Prandaj, është më mirë të hiqni dorë nga pirja e duhanit dhe të shpëtoni nga nervozizmi.

### ISH-DUHANPIRËSIT MBAJNË ERË MË TË KËNDSHME

Kur të hiqni dorë nga pirja e duhanit, nuk do të mbani më erë tymi të cigares. Tymi i cigareve nuk është aq i pakëndshëm për duhanpirësit, sepse atë erë mbajnë rrobat e tyre, atë erë e mbajnë fëmijët e tyre, me fjalë të tjera, është një erë e njohur në shtëpinë e tyre dhe atyre nuk u pengon. Por për 71% të evropianëve që nuk pinë duhan, era juaj e cigares është e pakëndshme. Madje mund të jetë një pengesë serioze për të krijuar dhe mbajtur shoqëri.

### ISH-DUHANPIRËSIT KANË MË SHUMË PARA

Një paketë prej 20 cigaresh kushton mesatarisht rreth 2.5 euro dhe çdo duhanpirës mund të përballojë të paktën një paketë në ditë. Nëse pini një paketë cigare në ditë, kjo është disa herë më e lartë se paga mesatare në vit. Ju mund ta llogaritni vetë dhe të siguroheni që nëse ndaloni pirjen e duhanit mund t'ia lejoni vetes të shkoni në pushime verore, dimërore ose të përjetoni disa fundjava të këndshme dhe përvoja të pafundme të paharrueshme. Çdo vit do të kurseni të paktën të njëjtën sasi parash dhe do të vazhdoni kështu për pjesën e mbetur të jetës tuaj. Nëse ndaloni pirjen e duhanit, do t'ia mundësoni vetes shumë përjetime të bukura dhe udhëtime të paharrueshme.

\*Teksti është marrë nga broshura "ISH-DUHANPIRËSIT KANË TË DREJTË"



Spec Dr. Ika Peshiq

Shefi i Kabinetit për parandalimin dhe heqjen dorë nga pirja e duhanit

Klinika e pulmologjisë, Qendra Klinike e Serbisë

Përktimi dhe përshtatja:

Instituti i Shëndetit Publik i Republikës së Maqedonisë Veriore



# ME NDRYSHIME TË VOGLA PËR NJË SHËNDET MË TË MIRË FIZIK DHE MENDOR

Përmes ndryshimeve të vogla në jetën e përditshme në një përmirësim të ndjeshëm të shëndetit fizik dhe mendor Ngjarjet e fundit të lidhura me pandeminë na kanë ballafaquar me një periudhë stresuese dhe traumatike. Qëndrimi në shtëpi dhe shndërrimi i atmosferës shtëpiake në një zyrë pune, shesh lojërash për fëmijë, hapësirë për ushtrime ose qëndrimi në një "mjedis të pasigurt dhe të rrezikshëm" për një kohë të gjatë, te shumë prej nesh shkaktuan ndryshime psikologjike, fizike, por më së shumti emocionale.

Pothuajse secili nga ne, në një moment të caktuar ka përjetuar frikë, ankth, mendime dëshpëruese, prekshmëri më të lartë, ndryshime në humor dhe oreks, ndjenja të pafuqisë dhe hutimit. Kur njerëzit janë të stresuar, shtrembërimi mendor është shpesh i pranishëm, gjë që çon në vetë-shkatërrim dhe mund të shkaktojë pasoja shumë të rënda në planin afatgjatë.

Kam 7 vjet që merrem me fitnes në mënyrë aktive dhe kam 4 vjet që punoj si psikologe. Në cilësinë e psikologes dhe trajneres së fitnesit, kam ardhur në përfundimin se trupi dhe shpirti si pjesë thelbësore të qenieve njerëzore janë të pandashme, çrregullimi i njërës shpesh çon në çrregullim të tjetrës. Kjo është arsyeja pse, për mendimin tim, stërvitja e mendjes është po aq e rëndësishme sa stërvitja e trupit. Nëse mendja dhe trupi janë në bashkërendim, atëherë mund të flasim për një person të plotë, me gjasa shumë më të ulëta të humbjes së mundshme.

S një person që dëshiron të ndihmojë të tjerët, e dija se duhet të isha fleksibile edhe në këtë situatë. Që në fillim, kur mendohesha se cila do të ishte mënyra më e mirë për t'i motivuar njerëzit të qëndrojnë të pranishëm dhe të vetëdijshëm gjatë vetëizolimit, vendosa të filloja filmimin e stërvitjeve të mia në shtëpi dhe të jepja këshilla për përmirësimin e shëndetit fizik dhe mendor. Gjatë gjithë periudhës, pothuajse deri në fund, isha aktive me stërvitje të përditshme dhe mesazhe motivuese për t'i mbajtur njerëzit zgjuar edhe nga shtëpia. Qëllimi im ishte të dërgoja mesazh të gjithë se kur kujdesemi për trupin, gjithashtu ndihmojmë në përmirësimin e shëndetit mendor. Ndonjëherë nuk të jepet të flasësh ose thjesht nuk ke me kë, por të ndan vetëm një stërvitje nga flakja e atyre mendimeve dhe energjisë negative, të cilat kanë zënë vend në trupin tënd dhe e kanë bërë vatër të gjithfarë ndikimesh që vijnë nga jashtë.

Është interesante që, ata që ushtrojnë rregullisht dhe i njohin përfitimet e aktivitetit fizik (ritja e sekretimit të edorfinës, përmirësimi i qarkulluar, ulja e stresit dhe mendimeve negative, përballimi i presionit të lartë të gjakut, parandalimi i sëmundjeve dhe forcimi i imunitetit etj.) e patën të lehtë të qëndronin aktivë dhe shumicën e kohës nuk kishin ndonjë vështirësi të madhe. Nga ana tjetër, shumë gra dhe vajza, të cilat nuk kishin qenë aktive dhe nuk ushtroheshin më parë, filluan të më shkruanin dhe të ushtroheshin me mua. Këtë e mora si një shenjë se megjithatë varet nga ne, nga secili individ, se sa do të përpiqemi të nxjerrim diçka pozitive nga një situatë e këtillë.

Ato vajza dhe gra që filluan të ushtroheshin me mua, më shkruanin çdo ditë se kishin vërejtur përmirësim në gjendjen shpirtërore, se flinin më mirë, se nuk sulmoheshin nga mendimet negative si më parë, se ia dilnin më mirë në krye me njerëzit më të dashur, megjithëse mendoj se edhe për fëmijët, si më të vegjlit ashtu edhe adoleshentët, kjo periudhë ishte mjaft stresuese dhe e panjohur.

Fakti që pashë se njerëzve u duhet vetëm një shtysë e vogël për të kaluar nga plogështia në 1 orë ushtrime në ditë, ishte dhe besoj se është ende motivimi im më i madh. Kur dikush që nuk ka qenë aktiv fizikisht kupton në gjendje pandemie se mbase kjo është një nga gjërat që do ta ndihmojnë ta kapërcejë më lehtë këtë periudhë, për mua do të thotë një përparim i jashtëzakonshëm.


Edhe pse palestrat janë hapur, jo të gjithë janë të gatshëm t'i kthehen stërvitjes në ambient të mbyllur dhe kjo është plotësisht normale. Madje disa edhe e parapëlqejnë aktivitetin fizik në natyrë. Leximi i librave, shëtitja në mal, ecja, çiklizmi, shikimi i serive të mira e të ngjashme, edhe më tej janë në dispozicionin tonë. Çdo aktivitet fizik ose mendor që individi e sheh



*Kjo është arsyeja pse,  
për mendimin tim,  
stërvitja e mendjes është po aq e  
rëndësishme sa stërvitja e trupit.*



*Le të jetë kujdesi për veten (mendor dhe fizik) në mesin e 3 përparësive kryesore për ne, si tani ashtu edhe në të ardhmen!*



*Sofija Maçeva  
psikologe, psikoterapiste nën mbikëqyrje dhe  
trajnere e fitnessit*

si një mjet për t'u përballur me mendimet dhe emocionet e veta është i mirëseardhur. Unë do të thosha se kjo periudhë është e keqe vetëm nëse e lejojmë që të jetë e tillë. Çdo gjë është në kokën tonë. Se sa do të investojmë në rritjen dhe zhvillimin tonë varet vetëm nga ne. Pandemia na dëshmoi se jeta në të vërtetë përbëhet nga gjëra të vogla dhe të thjeshta dhe se nuk na duhet shumë për të ndjerë lumturi dhe kënaqësi.

Ndërgjegjësimi, për mendimin tim, është shtytës dhe drejtimit që na prin në jetë dhe sa më shumë ta njohim atë, aq më të rehatshme dhe më të mirë do ta kemi jetën. Është vështirë për të gjithë, veçanërisht duke e pasur parasysh krizën financiare nga e cila do të na duhet kohë për të dalë, por në fund të fundit, gjëja më e rëndësishme është të qëndrojmë të pranishëm në të tashmen dhe të jetojmë pa menduar shumë se çfarë do të na sjellë e ardhmja, sepse armiku ynë më i madh janë mendimet, edhe atë mendimet për diçka që nuk jemi të sigurt se si do të jetë. Ne për fat të keq jemi një komb i tillë, që harrojmë shpejt se çfarë periudhe kemi kaluar, kurse pasojat do të ndjehen më së shumti nga ata që u preken drejtpërdrejt, por sinqerisht shpresoj se kjo periudhë do të lërë shenjë dhe do të nxjerrë në pah se çka është me të vërtetë e vlefshme në këtë jetë dhe për çka duhet të angazhohemi.



## ИМУНИКС

ПОМАГА ВО ЗАЈАКНУВАЊЕ НА ИМУНИТЕТОТ

ДОДАТОК НА ИСХРАНА

Една капсула содржи 100 mg прашок од спирулина и 10 mg пивски квасец збогатен со 20 µg селен.

**ИМУНИКС** капсулите имаат широка примена со бројни бенефити:

- Зајакнување на имунитет
- При неадекватна, нередовна и еднолична исхрана
- Состојби на зголемени потреби од витамини и минерали (повраќање, проливи и силно потење)
- При зголемена телесна активност

Дозирање:

- Деца на возраст од 7 до 14 години, 1 капсула на ден
- Возрасни и деца постари од 14 години, 1 до 3 капсули на ден



**BIONIKA**  
PHARMACEUTICALS  
www.bionikapharm.com



## STËRVITJES AUTOGJENE



Megjithë sukseset dhe arritjet e mjekësisë, numri i të sëmurëve sa vjen e rritet. Rreth dy të tretat e të gjitha sëmundjeve kanë prapavijë psikologjike ose shkaktohen nga faktorë psikologjikë. E gjithë kjo është pasojë e ritmit të shpejtë të jetës, ngarkimit shpirtëror në rritje, nga njëra anë, dhe aktivitetit fizik në rënie, nga ana tjetër.

Jeta moderne rrit nivelin e stresit tek njerëzit - njerëzit marrin përgjegjësi të panevojshme që u shkaktojnë dëm dhe lënë pasojë në shëndetin e tyre. Në këtë mënyrë ata hyjnë në një rreth vicioz nga i cili nuk mund të dalin as me ilaçet më të mira. Pavarësisht nëse bëhet fjalë për nervozizëm, probleme me stomakun, tension të lartë të gjakut apo sëmundje të civilizimit.

Stërvitja autogjene ofrohet si një metodë ideale që ndihmon personin "e konstruktuar gabimisht" të përshtatet në epokën e re. Shumë njerëz kanë ide të paqartë për atë se çfarë është stërvitja autogjene - e shohin si diçka magjike ose çudibërëse. Të paktë janë ata që e dinë se bëhet fjalë për një metodë shkencore, me ndihmën e së cilës vëmendja drejtohet nga trupi. Është një metodë me të cilën aspekti mendor dhe fizik përbëjnë një tërësi. Njeriu i jep drejtim psikikës së tij.

Stërvitja autogjene është një teknikë e relaksimit të thellë që i jep shtysë shëndetit fizik dhe mendor, lehtëson efektet e dëmshme të stresit dhe përmirëson cilësinë e jetës. Kjo lloj stërvitjeje është vërtetuar shkencërisht si teknikë për relaksim dhe vetë-ndihmë, ndërsa frymëzohet nga hipnoza, gjegjësisht një gjendje e sugjestibilitetit të shtuar dhe një metodë e manipulimit me anë të sugjerimit.

Stërvitja autogjene është një teknikë e ndihmës së vetvetes e zhvilluar nga Johannes Heinrich Schultz në fillim të shekullit të 20-të. Ajo që është veçanërisht e rëndësishme dhe e dobishme të stërvitja autogjene, por edhe të metodat e ngjashme të relaksimit, është fakti që gjatë stërvitjes do të mësoni të realizoni vetë ushtrimet. Kjo është shumë e rëndësishme për përparimin e mëtutjeshëm dhe punën me veten, sepse do të jeni në gjendje të zbatoni rregullisht teknikat e stërvitjes autogjene për të përmirësuar gjendjen tuaj psiko-fizike.

Stërvitja autogjene kryesisht ndihmon në rivendosjen e qetësisë së brendshme që trazohet vazhdimisht nga stresi i përditshëm. Rritja e rezistencës ndaj stresit është një nga qëllimet kryesore që arrihet përmes ushtrimeve dhe stërvitjes së vazhdueshme. Të gjitha teknikat, metodat dhe ushtrimet rikthejnë personit baraspeshën e trupit dhe një ndjenjë të qëndrueshme të vetë-kontrollit. Qëllimi kryesor është të kuptohet lidhja midis trupit dhe psikikës.

Shumë nga sëmundjet dhe streset e sotme kanë një efekt të thellë në gjendjen mendore të individit, gjë që thekson edhe më tepër rëndësinë e vendosjes së qëndrueshmërisë mendore. Stërvitja autogjene nuk është e paraparë vetëm për njerëzit që kanë probleme të caktuara me situata stresuese ose mosfunksionim psikologjik. Meqenëse nuk mund të thuhet se ka dikush që nuk përjeton stres, stërvitja autogjene mund të jetë e dobishme për këdo që kujdeset për shëndetin e vetë mendor.





Përfitimet nga stërvitja autogjene janë të panumërta. Ja vetëm disa nga ato:

- Baraspesha e jetës psikike,
- Shkallë më e lartë e relaksimit psikofizik,
- Normalizim i frymëmarrjes dhe funksionit vaskular,
- Përmirëson cilësinë e fjetjes dhe gjumit,
- Zvogëlon ankthin, tensionin fizik, shqetësimin,
- Rrit vetëbesimin dhe vetëvlerësimin,
- Jep një ndjenjë kontrolli dhe fuqizimi të vetvetes,
- Arritje e relaksimit dhe paqes në të gjitha rrethanat,
- Ballafaqim i suksesshëm me stresin,
- Arritje e qëndrueshmërisë emocionale,
- Ndryshim i stilit të jetës.

Stërvitja autogjene përdoret kryesisht në trajtimin e tensionit, panikut, frikës, ankthit, stresit dhe sëmundjeve psikosomatike. Teknikat e vetë-relaksimit përdoren nga njerëz të shëndetshëm për të përmirësuar përqendrimin, relaksimin, krijimtarinë, imagjinatën, formën fizike dhe gatishmërinë për punë. Rekomandohet veçanërisht për sportistët profesionistë.

Për kë është e paraparë stërvitja autogjene?

Stërvitja autogjene është e dobishme për të gjithë ata që kujdesen për shëndetin e tyre mendor, të gjithë personat e qëndrueshëm mendorisht që janë të ekspozuar ndaj situatave stresuese në jetën e përditshme: sportistët, studentët, mjekët, shkencëtarët, oficerët e policisë, amviset etj.

### Si vepron?

Stërvitja autogjene përbëhet nga 7 ushtrime themelore që ndihmojnë në arritjen e një gjendje relaksimi të plotë fizik dhe mendor. Qëllimi është që dalëngadalë të arrihet efekti i relaksimit të tërë trupit dhe kontrolli mbi trupin.



prof. d-r Slajana Angelkoska  
psikolog

Намалува зголемена телесна температура

Ублажува симптоми на настинка и грип

- главоболка
- болка во мускулите
- болка во грлото
- запушување на носот



**Defrinol**

20 филм-обложени таблети

Пред употреба внимателно да се прочита упатството!  
За индикациите, ризикот од употребата и несаканите дејства на лекот,  
консултирајте се со Вашиот лекар или фармацевт.



# Stresi oksidues - aplikimi i antioksidantëve

**Gjendjet e stresit** oksidues janë përgjegjëse për ndryshime të shumta patologjike në organizmin e njeriut që çojnë në sëmundje kronike si diabeti, sëmundjet kardiovaskulare, sëmundjet neurodegenerative, neoplazmat e shumta, sëmundjet autoimune. Gjithashtu, stresi oksidativ nënvizon mekanizmin patofiziologjik të simptomave klinike gjatë infeksioneve virale dhe të tjera. Një çekuilibër midis antioksidantëve dhe oksiduesve në favor të oksiduesve përkufizohet si stres oksidues. Radikalet e lira (oksiduesit) janë molekula që posedojnë një ose më shumë elektrone të paarritura dhe kështu kanë një tendencë të fortë për të marrë ose dhënë elektrone në molekula të tjera. Në atë mënyrë ata mund të çojnë në ndryshime në strukturën e molekulës dhe shkatërrimin e saj, dmth dëmtimin e qelizave dhe indeve në organizmin e njeriut. Ekzistojnë shumë lloje të radikaleve të lira, por më të rëndësishmet në sistemin biologjik janë ato që rrjedhin nga oksigjeni, të njohur si speciet reaktive të oksigjenit (ROS).

**Antioksidantët** janë molekula që mund të dhurojnë një elektron në një radikal të lirë pa u bërë i paqëndrueshëm në vetvete. Kjo bën që radikalet e lira të bëhen më të qëndrueshme dhe kështu më pak reaktive. Ky koncept është baza e veprimit parandalues dhe terapeutik i antioksidantëve në praktikën e përditshme klinike. Përdorimi i shtojcave dietike që përmbajnë substanca me efekt antioksidues është pjesë e procedurave moderne terapeutike si për sëmundjet kronike ashtu edhe për ato akute, siç janë infeksionet virale. Zbatimi i duhur i tyre parandalues mund të jetë edhe më domethënës.

**Superoksid dismutaza** është linja e parë e mbrojtjes kundër dëmtimit të radikalit të lirë të shkaktuar nga oksigjeni. **Acidi alfa-lipoik** është një antioksidant i fuqishëm që neutralizon funksionet e shumta të radikalëve të lirë me efekte të provuara siç janë neuroprotektive, anti-inflamatore, vazodilatatore dhe hipoglikemike. **Prania e njëkohshme e acidit alfa-lipoik dhe superoksid dismutazës në shtesat dietike siguron një efekt të dyfishtë në mekanizmin antioksidant.** Dismutaza e superoksidit parandalon formimin e radikalëve të lirë, ndërsa acidi alfa-lipoik neutralizon radikalet e lira të krijuara nën stresin oksidues.

Selenoproteinat me të cilat lidhen efektet biologjike të **selenit duhet** të veçohen si një grup i veçantë me vetitë antioksiduese. **Seleni** është një mikronutrient thelbësor me efekte të rëndësishme në shëndetin e njeriut. Funksioni kryesor i selenit është në përbërjen e glutacione – peroksidaza mbron organizmin nga stresi oksidues dhe luan një rol të rëndësishëm në rregullimin e prodhimit të hormonit aktiv tiroid (T3). Kështu, seleni ndikon ndjeshëm në funksionimin e duhur të gjëndrës tiroide, dhe përmes selenoproteinave të tjera ka një rol indirekt në përmirësimin e stresit oksidues në organet e tjera dhe sistemet e organeve. Forma organike e selenit në formën e L-selenmetioninës me një dozë prej 200 mcg ka biodisponibilitet dukshëm më të lartë në krahasim me format joorganike të selenit.



- ✓ Acidi alfa-lipoik në një dozë prej 570 mg
- ✓ Superoksid dismutaza në një dozë prej 10 mg

Mbështetje për trajtimin e polenuropatisë diabetike dhe të gjitha kushteve të tjera të shkaktuara nga stresi oksidues, përfshirë infeksionet virale

**VEMAX**

PHARMA

[www.vemaxpharma.rs](http://www.vemaxpharma.rs)



# Çfarë është botoksi?



Botoksi është një proteinë natyrore e krijuar nga bakteri *C. botulinum*, që fillimisht gjeti zbatim në mjekësi në trajtimin e sëmundjeve të brendshme të natyrës neurogenike. Si bllokues i impulseve nervore nga truri duke synuar indet muskulore, shumë shpejt u kuptua se Botoksi mund të ishte shumë efektiv në trajtimin e rrudhave që shfaqen në fytyrë dhe qafë. Funkzioni i tij është të shtendosë muskujt e fytyrës dhe kështu t'i zvogëlojë ose eliminojë rrudhat që shfaqen për shkak të lëvizjes (mimikës) së atyre muskujve.

Trajtimi është i thjeshtë dhe i shpejtë, ndërsa efektet janë të dukshme 7 ditë pas aplikimit. Është një metodë minimale invazive që nuk kërkon kushte të veçanta ose kujdes pas trajtimit, kurse efektet zgjasin me muaj. Procedura përfshin pickimin e lehtë të tufave të buta muskulore të fytyrës dhe aplikimin e

dozave shumë të vogla të tretësirës Botoks, pas së cilës efekti më i pakëndshëm anësor i mundshëm është një mavijosje e vogël, për shkak të individualitetit të anatomisë së secilit person.

Indikacionet tashmë i përmendëm, por përveç rrudhave, Botoksi është i pazvëndësueshëm edhe në trajtimin e djersitjes së tepërt nën sqetulla, pëllëmbë dhe thembra. Botoksi është po ashtu i shkëlqyeshëm në trajtimin e migrenës, ku përmes aplikimit në muskujt e kafkës, dhimbja dhe sikleti zvogëlohen plotësisht. Kundëriindikacionet e trajtimit janë të gjitha proceset lokale të pranishme në vendin e injektimit (infeksione, malinjitetet etj). Përveç kësaj, trajtimi është plotësisht i sigurt dhe madje nuk ka asnjë ndikim gjatë shtatzënisë. Metoda këshillohet të përsëritet pas disa muajsh (4-6 muaj) për shkak të efekteve kalimtare të Botoksit.



d-r Kosta Cvetkovic  
spec. dermatovenerologjisë



× КОМБИНИРАНА МОК НА  
ХЛОРХЕКСИДИН И CITROX®

НОВО

CURAPROX  
PERIOPLUS+

ПОДОБРЕНА  
ФОРМУЛА  
ЗА ЕФИКАСНА  
ЗАШТИТА  
НА ЗАБИТЕ И  
НЕПЦАТА



Производите CURAPROX Perio Plus+ можете да ги купите во аптеките и специјализираните дрогерии.

Curaprox Macedonia curaprox\_macedonia

www.interdental.mk

SWISS PREMIUM ORAL CARE



# INFEKSIONET E TRAKTIT URINAR

Infeksionet e traktit urinar janë një nga infeksionet bakteriale më të zakonshme dhe të vazhdueshme të veshkave, rrugëve urinare dhe fshikëzës së urinës. Mënyra kryesore e transmetimit të infeksionit (90%) është me hyrjen e baktereve nga rektumi dhe organet gjenitale në fshikëz. Infeksioni më shpesh qëndron në traktin urinar të poshtëm, përkatësisht në fshikëzën e urinës (cistiti) dhe uretër (uretriti).

Shkaqet e infeksioneve të traktit urinar janë bakteret gram-negative, si *Escherichia coli*, *Proteus*, *Klebsiella*, *Enterobacter*, *Pseudomonas*. *Escherichia coli* është shkaku kryesor që vërehet në 90% të pacientëve me infeksione të traktit urinar. Infeksionet e traktit urinar më shpesh paraqiten tek gratë, por edhe tek burrat në një moment të jetës së tyre, duke shkaktuar inflamacion që mund të jetë akut ose nëse nuk trajtohet siç duhet, mund të çojë në sëmundje kronike. Infeksionet e traktit urinar mund të jenë mjaft "të bezdisshme" dhe të dhimbshme, kështu që ato duhet të merren seriozisht, kurse hapat për parandalimin dhe trajtimin e tyre duhet të ndërmerren në kohën e duhur.

***Simptomat që do t'ju tërheqin vërejtjen dhe do t'ju bëjnë me dije se keni një infektion të mundshëm të traktit urinar janë këto:***

- Nevojë e fortë për të urinuar, që nuk mund të lihet për më vonë
- Djegie gjatë urinimit
- Erë e fortë e urinës
- Dhimbje gjatë urinimit
- Pamje e turbullt e urinës, që mund të përmbajë edhe gjak
- Dhimbje në legen te gratë - më shpesh në pjesën qendrore.

Nëse është diagnostikuar tashmë një infektion i traktit urinar, fillohet me fazën e trajtimit. Trajtimi zakonisht përfshin përdorimin e antibiotikëve, por nëse kemi të bëjmë me një formë më të butë të inflamacionit, antibiotikët mund të përjashtohen nga përdorimi. Trajtimi alternativ për infeksionet e traktit urinar




është i njohur tashmë për një numër të madh të pacientëve që kanë përjetuar ndonjëherë një problem të tillë dhe përfshin përdorimin e boronicës dhe pirjen e sasive më të mëdha të lëngjeve.

Por çfarë e bën në të vërtetë lëngun e boronicës kaq efektiv në trajtimin e infeksioneve të traktit urinar? Efektiviteti i lëngut të boronicës është për shkak të sheqerit të thjeshtë që ai përmban, gjegjësisht D-manoza. D-manoza është treguar se është 10 deri 50 herë më efektive se lëngu i boronicës. Ajo funksionon duke formuar koagregate me bakterin *Escherichia coli*, të cilat më pas nxirren përmes urinimit, duke lënë bakteret e mira të paprekura dhe duke lënë një shtresë mbrojtëse që parandalon rikthimin e baktereve të dëmshme.

Studimet e fundit kanë treguar rezultate domethënëse nga preparatet që përmbajnë D-manozë në kombinim me probiotikë. Një studim ku morën pjesë 45 gra me moshë mesatare 40 vjeç, me infektion të traktit urinar, zbuloi se përdorimi i D-manozës në një përqendrim prej 2 gram në ditë, në kombinim me probiotikë dhe prebiotikë, në 30.3% të grave zvogëloi pjesën më të madhe





të simptomave në 15 ditët e para, kurse në 30 ditë ajo përqindje u rrit në 90.9%. D-manoza gjithashtu ndikon në kohën e përsëritjes, pra infeksionit të sërishëm. Te pacientët që përdorin D-manozë në trajtimin e infeksionit të traktit urinar, infeksioni përsëritet pas mesatarisht 200 ditësh, ndryshe nga antibiotikët klasikë, te të cilët shkalla mesatare e përsëritjes është vetëm 53 ditë! Përdorimi i probiotikëve si *Saccharomyces boulardii*, përveç përmirësimit të florës së zorrëve dhe zvogëlimit të efekteve negative të antibiotikëve, gjithashtu ka një efekt të drejtpërdrejtë të *Escherichia coli*. Një studim ku morën pjesë 24 fëmijë midis moshës 3 dhe 16 vjeç tregoi një ulje të ndjeshme të përqendrimit të bakterit *Escherichia coli* nga 445.74 g/ml në 62.83 g/ml. Po ashtu nuk duhet të harrojmë se bëhet fjalë për një preparat natyror, që D-manoza është e sigurt për t'u përdorur dhe mund të përdoret tek fëmijët, gratë shtatzëna dhe njerëzit me diabet. Nëse është e nevojshme, mund të përdoret së bashku me antibiotikë, por vetë D-manoza është efektive në rast të infeksioneve akute, të pakomplikuara të traktit urinar dhe, siç e përmenda, parandalon përsëritjen e infeksioneve të traktit urinar.



Mr. Farm Goran Ristovski

*Infeksionet e traktit urinar mund të jenë mjaft "të bezdisshme" dhe të dhimbshme, kështu që ato duhet të merren seriozisht, kurse hapat për parandalimin dhe trajtimin e tyre duhet të ndërmerren në kohën e duhur.*

PharmaS  
**UriRoyal**

Д-маноза +  
пробиотик  
(*S. Boulardii*)

## Кралско решение за здравје на вашите мочни патишта!

- ◆ **ЕДИНСТВЕНА КОМБИНАЦИЈА** (Д-МАНОЗА + *S. Boulardii*)
- ◆ **БРЗО И ЛЕСНО** ги намалува тегобите
- ◆ **ОДЛИЧНА ПОДНОСЛИВОСТ**, без несакани ефекти
- ◆ **ПОГОДЕН ЗА:** ДЕЦА над 3 години, ТРУДНИЦИ, ДОИЛКИ, ДИЈАБЕТИЧАРИ
- ◆ **ПРИЈАТЕН ВКУС** со арома на брусница
- ◆ **ЕДНОСТАВНА ПРИМЕНА** - прашок, лесно растворлив во вода 1xДен



\* 7 kesички со прашok за rastvoraње. UriRoyal granuli za deca i vozrasni.

PharmaS

ПхармаС Лекови доел, Бул. 8-ми Септември 2/2-2/5, 1000 Скопје Р. Македонија | Т:+389 2 2550 350 | Ф:+389 2 2550 351



# Çfarë prindi jeni?

## 1. SI VEPRONI KUR DËSHIRONI QË FËMIJA JUAJ TË BËJË VETË DIÇKA TË RE?

- A) Ia sqaroj me hollësi se çfarë duhet të bëjë dhe pse
- B) Ia ofroj të gjitha kushtet për t'ia dalë mbanë
- C) Do ta bëj vetë dhe do ta lë të mësojë duke më parë mua

## 2. SA SHPESH I THONI FËMIJËS TUAJ QË E DONI?

- A) Sa herë që arrin sukses në diçka ose kur rri urtë
- B) Vazhdimisht, pa ndonjë arsye
- C) Zakonisht para gjumit

## 3. FËMIJA JUAJ NUK DËSHIRON TË BËJË DETYRAT E SHTËPISË...

- A) Nuk do të lëshoni pe derisa t'i përfundojë dhe t'i keni kontrolluar
- B) Mbase është i lodhur dhe do ta lejon
- C) Do t'i shpjegoj se përse është e rëndësishme që të marrë përsipër përgjegjësitë e veta

## 4. CILA ËSHTË METODA JUAJ PËR TA MËSUAR FËMIJËN TUAJ SE AI DUHET TË BËJË VETË DISA GJËRA?

- A) I tregoni për rëndësinë e të qenit i pavarur
- B) E inkurajoni që nëse nuk mund të bëjë diçka vetëm, mund të mbështetet gjithmonë në ndihmën tuaj
- C) E mësoni me shembujt tuaj dhe gjërat që ju i bëni vetë

## 5. ËSHTË KOHA PËR TË SHKUAR NË SHTRAT, POR FËMIJA JUAJ NUK DËSHIRON TË FLEJË NË SHTRATIN E VET

- A) Do ta detyroni të flejë në shtratin e vet. Duhet të mësohet me disiplinë.
- B) Do të bëni përjashtim dhe nuk do ta bindni
- C) Do t'i shpjegoj se nëse fle në shtratin e vet, do të bëjë gjumë më të këndshëm dhe më të rehatshëm

## 6. KUR GATUANI...

- A) Përgatisni vakte praktike dhe të shpejta
- B) Gatuani ushqimet që u pëlqejnë fëmijëve tuaj
- C) Herë sipas dëshirës suaj, herë sipas dëshirës së tyre

## 7. NËSE VËRENI QË FËMIJA JUAJ SHITRET SE ËSHTË I SËMURË PËR TË MOS SHKUAR NË SHKOLLË, ÇFARË DO T'I THONI?

- A) A dëshiron të flasim për gjërat që të shqetësojnë në shkollë?
- B) Si mund të të ndihmoj që të ndihesh më mirë?
- C) Nuk guxon të më gënjesh, shpejt në shkollë!

## 8. KËTO JANË FJALËT QË PËRSHKRUAJNË DISIPLINËN TUAJ:

- A) Çdo fëmijë duhet të dijë kufijtë e tij
- B) Engjëlli im i vogël nuk meriton rreptësi
- C) Veprimet e gabuara duhet të korrigjohen. Ndonjëherë edhe me ndëshkime.

## 9. KUR FËMIJA JUAJ TË RRRITET, DUHET TË JETË...

- A) një person i përgjegjshëm
- B) Dua që të jetë një person i lumtur
- C) Mjafton të komunikojë gjithmonë me mua, pavarësisht moshës

## 10. KUR TË VIJË KOHA PËR TË ZGJEDHUR FAKULTETIN...

- A) Nuk do të doja të studiojë larg shtëpisë
- B) Edhe nëse është larg, mjafton të vijë shpesh për vizitë
- C) Do të pranoj gjithçka për hir të arsimimit të tij

## 11. KUR PRISHET LODRA E TIJ E PARAPËLQYER, SI REAGONI?


- A) Do t'i shpjegoj që herën tjetër duhet të jetë më i kujdesshëm
- B) Do të blej menjëherë një të re
- C) Do t'i them: e di që je i mërzitur, edhe unë do të isha i/e mërzitur...

## 12. ÇFARË PRINDI MENDONI SE JENI?

- A) I disiplinuar
- B) Shumë i kujdesshëm
- C) I arsyeshëm

## 13. CILAT JANË TRE GJËRAT QË DO TË DËSHIRONIT T'IA KALONIT FËMIJËS SUAJ?

- A) Rend, përgjegjësi dhe drituri
- B) Ndërgjegje, dhembshuri dhe durim
- C) Guxim, mençuri dhe dashuri







### Nëse keni më shumë përgjigje nën A

Jeni një prind mjaft autoritar dhe i rreptë, i cili shpesh pyet veten nëse po vepron siç duhet gjatë edukimit të fëmijës së vet. Kërkoni shpjegime të arsyeshme, por megjithatë doni që fjala e fundit të jetë e juaja. Ju dëshironi që fëmija juaj të jetë shembullor, i pavarur dhe i fortë.



### Nëse keni më shumë përgjigje nën B

Dashuria për fëmijën tuaj është e shenjtë për ju dhe gjithçka që lidhet me të është në qendër të botës suaj. Për ju, lumturia e tij është më e rëndësishmja dhe kjo është arsyeja pse shpesh devijoni nga rregullat dhe ndëshkimet e rrepta. Jeni një nga ata prindër tepër të kujdesshëm dhe "të butë".



### Nëse keni më shumë përgjigje nën C

Për ju, balancimi është mjete më i rëndësishëm për rritjen e një fëmije. Dini të jeni i rreptë, por edhe i butë në një masë të arsyeshme. Ju gjithmonë dëshironi të gjeni logjikën në veprimet dhe reagimet e fëmijës suaj. Jeni të ndjeshëm dhe autoritarë në të njëjtën kohë.

[www.replek.com.mk](http://www.replek.com.mk)

# ОРАЛСЕПТ® ДУО СПРЕЈ

## МОЌНА ЗАШТИТА ПРИ БОЛНО ГРЛО



ДВОЕН  
АНТИМИКРОБЕН  
ЕФЕКТ



НАМАЛУВА  
БОЛКА  
ВО ГРЛОТО



ГИ НАМАЛУВА  
ЗНАЦИТЕ НА  
ВОСПАЛЕНИЕ



ДЕЛУВА  
ЛОКАЛНО



ДОЛГА ПРСКАЛКА ЗА ЛЕСНА АПЛИКАЦИЈА

ПРЕД УПОТРЕБА ВНИМАТЕЛНО ДА СЕ ПРОЧИТА УПАТСТВОТО!

За индикациите, ризикот од употреба и несаканите дејства на лекот консултирајте се со вашиот лекар или фармацевт.

 **РеплекФарм**



Носот е  
вреден  
инструмент.

**СептаНазал**<sup>®</sup>  
ксилометазолин+декспантенол



**Септаназал брзо помага  
при затнат нос и лекува.**



Делува  
брзо по  
само 5 до 10  
минути



Помага при  
затнат нос и  
го намалува  
исцедокот



Ја лекува  
оштетената  
носна  
слузница

[www.krka.mk](http://www.krka.mk)

 **KRKA**

*Нашата иновативност и знаење  
создаваат ефикасни и сигурни  
производи со највисок квалитет.*

[www.septanazal.mk](http://www.septanazal.mk)

Пред употреба внимателно да се прочита упатството!  
За индикациите, ризикот од употребата и несаканите дејства на лекот  
консултирајте се со Вашиот лекар или фармацевт.



# HOROSKOP

## Shtator



DASHI 21.03-20.04

Ky është muaj kur Hëna do të ketë një ndikim të madh në shenjë tuaj, çka do t'ju bëjë të ndiheni shumë energjikë për fillimet e reja. Diku nga mesi i shtatorit, do të përballeni me disa sfida të cilat do t'ju detyrojnë të bashkërendoni planet tuaja me shenjat që ju dërgon trupi.




DEMI 21.04-20.05

Ndodheni në një periudhë kur do të keni mundësinë të përsosni aftësitë e të shprehurit, të shkruarit dhe të krijuarit. Shfrytëzoni sa më shumë motivimin në fushën e sportit. Shqyrtoni mundësitë e stërvitjes në ambient të hapur dhe shijoni ditët e fundit të verës me aktivitete që do t'ju ndihmojnë të mirëmbani pamjen e jashtme.



BINJAKËT 21.05-20.06

Shtëpia, familja dhe ndjenjat do jenë disa nga gjërat që do të shënojnë shtatorin. Sidomos në gjysmën e parë të muajit do të ndiheni se keni nevojë për pushime, që do të jetë një mundësi e shkëlqyeshme për të ushqyer vlerat tuaja familjare. Mos harroni të pini sasi të mjaftueshme të lëngjeve dhe mos e lini pas dore marrjen e përditshme të vitaminave.



GAFORRIA 21.06-20.07

Hiqni qafe shqetësimet për karrierën tuaj dhe gjeni gjëra që ju kënaqin dhe ju zvogëlojnë stresin e përditshëm. Shfrytëzoni çdo moment të lirë për t'i kushtuar më shumë kohë vetes, sepse ju pret një periudhë që nëse nuk ju gjen të përgatitur, do t'ju rraskapitë si fizikisht ashtu edhe mendërisht.



LUANI 21.07-21.08

Muaji shtator ju premtan shumë ditë të frytshme dhe aktive. Që të mos e humbni entuziazmin dhe të nxirni më të mirën nga vetja, përpikuni të ushqeheni shëndetshëm dhe të ngopeni me gjumë. Sado që ta ndjeni veten të përgatitur për detyrat e caktuara rishtas, mos e ngarkoni veten me detyra shtesë.



VIrgjërësHA 22.08-22.09

Disa prej jush që do të festojnë ditëlindjen do të ndiejnë valën e re të emocioneve dhe frymëzimit për fillime të reja. Nëse po kaloni një periudhë kur ndiheni të plogësht, praktikoni shëtitje në natyrë dhe shoqërohuni me të dashurit tuaj. Disa pjesëtarë të kësaj shenje do të ndjehen të lodhur dhe të rraskapitur.



PESHORRIA 23.09-22.10

Ndikimi i Venerës dhe Saturnit premtan ndryshime të rëndësishme në karrierën tuaj, gjë që do të rrisë vetëbesimin tuaj. Nëse keni sëmundje kronike, shmangni situatat stresuese edhe nëse kjo nënkupton heqjen dorë nga disa përgjegjësi tuajat. Kujtojani vetes se ankthi dhe stresi ndikojnë drejtpërdrejt në imunitetin tuaj, që përbën një rrezik të drejtpërdrejtë për shëndetin.



AKREPI 23.10-22.11

Shfrytëzoni javën e parë të shtatorit për t'u përqëndruar në idealet dhe qëllimet tuaja. Bëni një listë të të gjitha gjërave që ndikojnë në humorin tuaj dhe ju mbushin me energji pozitive. Mos i anashkaloni kontrolltet e rregullta te mjeku dhe merrni vitamina dhe minerale çdo ditë.



SHIGJETARI 23.11-20.12

Optimizmi juaj i zakonshëm mund të lëkundet pak kur përballeni me situata dhe ngjarje që ju bëjnë të ndiheni të zhgënjyer. Ulja e pritshmërive do të ndihmojë në zvogëlimin e kësaj ndjenje, duke ju ndihmuar të ruani gjendjen e mirë shpirtërore. Ushqeni imunitetin dhe ndiqni shenjat që jua dërgon trupi juaj.



BRICJAPI 21.12-19.01

Në gjysmën e parë të shtatorit duhet të mënjanoi të gjitha toksinat nga trupi juaj dhe të filloni një dietë të përshtatshme detoksifikuese. Mbani në mend se shumica e problemeve shëndetësore vijnë nga marrja e pamjaftueshme e vlerave ushqyese. Përgatitni trupin tuaj për sezonin e ardhshëm të ftohtëve.



JUORI 20.01-18.02

Periudha që latë pas ishte e mbushur me rrëmujë dhe kaos. Le të jetë shtatori porta përmes së cilës do të kaloni drejt fillimeve dhe miqësive të reja. Përqëndrohuni në trupin tuaj dhe filloni të ushtroni, nëse tashmë nuk e bëni. Nëse jeni një nga ata që vazhdimisht gjen justifikime për të mos e bërë, mund t'ju duhet të njiheni me meditimin, që do t'ju ndihmojë të qetësoni temperamentin tuaj.



PESHQIT 19.02-20.03

Energjia juaj krijuese po kërkon rrugën e duhur për të dalë në pah. Mos e nxitoni procesin; ndani kohë për veten, për t'u shoqëruar me të afërmit tuaj dhe për të krijuar çaste të lumtura që do t'ju nguliten në kujtesë. Ju pret një periudhë me shëndet të mirë dhe humor të shkëlqyeshëm.



**MANASTIRI**Barnatore Viola  
047-222-235Barnatore Neo Farm  
047-224-301Barnatore Farm-Zdravje  
047-223-039Barnatore Farm-Zdravje 2  
047-242-039**Demir Hisar**Barnatore Dehi Farm  
047-276-644**GJEVGJELIA**Barnatore Nima  
034-214-562**GOSTIVARI**Barnatore Botanik  
042-211-413Barnatore Diti Farm  
042-212-164Barnatore Mikrofarm  
042-371-622Barnatore Pro-Farm  
042-213-132Barnatore Vivalek 4  
042 313496Barnatore Diti Farm 3  
042-622-888**GOSTIVAR F. ÇEGRANE**Barnatore Med-Farm  
042-321-363**GOSTIVAR F. DOBRI DOL**Barnatore Genius-Farm  
042-311-229**GRADEC**Barnatore Albi Farm  
071-822-270**KAVADAR**Barnatore Farmakon-Lek  
043-411-891Barnatore Farmanea  
043-550-900**KËRÇOVA**Barnatore Herba 1  
045-223-978Barnatore Herba 2  
045-261-265Barnatore Blina  
045-222-550**KOÇANI**Barnatore Fitomed  
033-273-805Barnatore Higija Farm  
033-271-522**KR. PALLANKA**Barnatore Qytet Kr. Pallanka  
031-375-012**KRIVOGASHTANI**Barnatore Menta Farm 4  
048-471-987**KUMANOVË**Barnatore Adonis  
031-411-098Barnatore Dafina  
031-413-977Barnatore Isidora  
031-550-635Barnatore Kamilica  
031-550-603Barnatore Novalek  
031-422-111Barnatore Farmalek  
031-416-503Barnatore Filiz  
031-416-700Barnatore Kaiser Farm  
078/452-702Barnatore Zani Farm  
031-445-434**NEGOTINA**Barnatore Negotino  
043-361-433

Barnatore Negotino 1

**NOVO SELLE**Barnatore Zdravje  
034-522-279**OHËR**Barnatore Bio-Lek  
046-260-580Barnatore Kavaj  
046-260-940Barnatore Pasholi  
046-255-070Barnatore Planta  
046-250-533Barnatore Heledona  
046-257-744**PRILEP**Barnatore 2005 VIVA FARM  
048-400-901Barnatore Biolek  
048-416-208Barnatore Karakash 1  
048-414-722Barnatore Menta Farm 1  
048-422-551Barnatore Ortofarm  
048-436-100**PROBISHTIP**Barnatore Ema Farm  
032-482-666**RADOVISH**Barnatore Filip Vtorni  
071-945-549**RESNJË**Barnatore Sigia-Farm Resnje  
047-454-360Barnatore Farma-Lek-2005  
047-452-553**F. DOLLNO PALÇISHTE**Barnatore Losiones Medika  
044-391-025**SHKUP**Barnatore Aloe  
02-2039-915Barnatore Ambrozija Farm  
02-3224-399Barnatore Andra Lek  
02-3225-422Barnatore Vivalek 1  
02-2617-740Barnatore Vivalek 2  
02-2562-222Barnatore Vivalek 3 Creshevo  
02-2573-953Barnatore GoldMun 2  
02-2616-338Barnatore GoldMun3  
02-2635-555Barnatore GoldMun 5  
02-2431-600Barnatore GoldMun7  
070-269-866Barnatore GoldMun 8  
02-2666-840Barnatore Da-Jana-Farm  
02-2655-500Barnatore Datel Farma  
02-2612-536Barnatore DNA ANNI FARM 3  
02-2445-935Barnatore Jasmin  
02-2794-349Barnatore LAJFLAJN  
02-3075-576Barnatore Lincura  
02-2434-600Barnatore Mak Farm  
02-3071-289Barnatore Makmedika  
02-2031-082Barnatore Nela Farm  
076-407-000Barnatore Nika Farm  
02-2572-801Barnatore Nika Farm 1  
02-2545-111Barnatore Omega Farm 1  
02-3125-202Barnatore OmegaFarm 3  
02-3114-086Barnatore Opium  
02-2440-335Barnatore Oskar lek  
02-3132-227Barnatore PavloFarm  
02-2467-589Barnatore Polin  
02-2432-002Barnatore Regina  
02-2622-205Barnatore Sara Farm 1  
02-2792-880Barnatore Sara Farm3  
02-3220-049Barnatore Sara Farm 4  
02-3113-129Barnatore Saraj Farm  
02-2057-069Barnatore Stem  
02-3176-335Barnatore Datel Farma Qendër  
075-265-564**SHTIP**Barnatore Biolek  
032-391-777Barnatore Dijana  
032-392-707Barnatore Zdravje 1  
078 264 148Barnatore Zdravje 2  
078 264 141Barnatore Medifarm  
032-394-143Barnatore Radolek  
032-380-190**STRUGA**Barnatore Bela-Dona  
046-786-750Barnatore Hamamelis  
046-702-706**STRUGA F. VRANISHTA**Barnatore Hamamelis 2  
046-702-706**STRUMICA**Barnatore Verbena  
034-551-031Barnatore Zanina  
034-346-972Barnatore Zanina 2  
079-273-700Barnatore Panacea  
034-320-395Barnatore Farmaka  
034-322-251Barnatore Verbena 2  
034-550-519**TETOVË**Barnatore Bami Kor Medika  
044 335 747Barnatore Qytet Tetovë  
044-334-425Barnatore Eliskir  
070-887-393Barnatore Herba  
044-335-145Barnatore Andol-G  
044-347-049Barnatore Biofarm  
044-344-292Barnatore Vital-Farm  
071-536-614Barnatore Dushica Farm  
044-451-002Barnatore Medika  
044-339-466

Barnatore Losiones Medika Farm 1

**TETOVË F. PIROK**Barnatore Sano Farm  
044-371-579**TETOVË F. TEARCË**Barnatore Herba Farm 2  
071-224-827**TETOVË, F. VRATNICË**Barnatore Mena Farm  
078-415-079**VEVÇAN**Barnatore Bela-Dona  
070-362-210**VELES**Barnatore Ziva Farm 1  
043-235-121Barnatore Ziva Farm 2  
043-251-005Barnatore Ziva Farm 3  
043-230-121Barnatore Ziva Farm 4  
043-225-255Barnatore Ziva Farm 5  
078-371-585Barnatore Magna Farm 2  
043-211-499**VINICA**Barnatore Arka  
033-362-685Barnatore Arka Nova  
033-364-685



ЗА ОДМОР БЕЗ ПРОБЛЕМ - НЕ ОДЕТЕ БЕЗ **СИНОПЕН**

# Synopen®



ПРОТИВ АЛЕРГИСКИ РЕАКЦИИ НА КОЖА И КАСНУВАЊЕ ОД ИНСЕКТИ.  
СО СМИРУВАЧКО И БРЗО ДЕЈСТВО (5-10 минути од примената).



ПЛИВА доел Скопје, Никола Парапунов бб, Скопје тел/факс: 02 3062 702

MK/SYPN/19/0001

 **PLIVA**

Членка на групацијата Teva

ПРЕД УПОТРЕБА ВНИМАТЕЛНО ДА СЕ ПРОЧИТА УПАТСТВОТО!  
ЗА ИНДИКАЦИИТЕ, РИЗИКОТ ОД УПОТРЕБА И НЕСАКАНИТЕ ДЕЈСТВА НА ЛЕКОТ КОНСУЛТИРАЈТЕ СЕ СО ВАШИОТ ЛЕКАР ИЛИ ФАРМАЦЕВТ





NATURA  
THERAPY

2+1 ПАКЕТ  
ЗА САМО

1990 ден.

Купи здравје  
од природата!



ГРАТИС  
СПИРУЛИНА



Додаток на исхраната за  
елиминација на болката во  
зглобовите.

  naturatherapy.mk  
www.naturatherapy.mk

070/230 720  
contact@naturatherapy.mk